



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe nenit 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a** dhe nenit 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.02.2020, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Arton Topanica, Ismit (Avdi) Shabani, Sabit (Avdi) Shabani , Adem (Shaban) Berisha dhe Sylejmon (Sadik) Topanica.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 04534-0, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-04534-0, Zona kadastrale Tophane, Prishtinë, pjesë e parcelës nr. 04580-0, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-04580-0, Zona kadastrale Tophane, Prishtinë, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesë e parcelës kadastrale nr. 004604-2, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-004604-2, Zona kadastrale Tophane, Prishtinë, pjesë e parcelës 004603-2 , Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-004603-2, Zona kadastrake Tophane, Prishtinë, pjesë e parcelës nr. 004608-2, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-004608-2, Zona kadastrale Tophane, Prishtinë, pjesë e parcelës 004609-2, Certifikata e pronësisë, nr. P-71814059-004609-2, Zona kadastrale Topëhane, Prishtinë , pjesë e parcelës nr. 004610-4, Certifikata e pronësisë, nr. P-71814059-004610-4, Zona kadastrale Tophane, Prishtinë, në pronësi të Arton Topanica, Ismit (Avdi) Shabani, Sabit (Avdi) Shabani , Adem (Shaban) Berisha dhe Sylejmon (Sadik) Topanica.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues "Tophane" në Prishtinë.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.

VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01-464/01-33127/20, më 10.02.2020

KRYESUESI I KUVENDIT

Agim Kuleta

